



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 539/5 prot.

Tiranë, më 13.11.2018

**V E N D I M**

Nr.89, Datë 13/11/2018

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË  
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES  
VENDORE, BASHKIA MIRDITË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR  
TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Mirditë,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 539, datë 22.06.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Mirditë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin, Bashkia Mirditë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 539/1 prot., datë 22.06.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 539/2 prot., datë 22.06.2018 “Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Mirditë”, i është njoftuar këtij institucioni.

Bashkia përfshihet si subjekt i mbikëqyrjes së Komisionerit, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 539/3 prot., datë 08.10.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Mirditë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 4643 prot., datë 24.10.2018, “Dërgim projekt raporti”, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Mirditë, dhe të paralajmëroj institucionin

për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Kryetari i Bashkisë Mirditë, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit:

- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist Auditi në Njësinë e Auditit të Brendshëm*”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion, në këtë pozicion, me urdhrin nr. 86, datë 12.04.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Inspektor për pasurinë e paluajtshme dhe asetet publike në Sektorin e të Ardhurave – Taksa Tarifa dhe Qira në Drejtorinë e Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit*”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 148, datë 25.05.2017, të Kryetarit të Bashkisë;
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist i monitorimit të tregut dhe transportit në Sektorin e Apelimit, Monitorimit Tregut dhe Transportit në Drejtorinë e Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit*”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 21, datë 02.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist për problemet e integritetit me BE, në Sektorin Juridik*”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 87, datë 12.04.2017, të Kryetarit të Bashkisë.

Njësia përgjegjëse, të fillojë menjëherë procesin e plotësimit të këtyre pozicioneve, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore përkatëse.

3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mirditë, në lidhje me rastin e punonjësit \*\*\*\*\*, i cili nuk plotëson kriterin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës, ashtu si është parashikuar në Lidhjen nr. 2, Klasa III/1 dhe III/2, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimit e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet si më poshtë:

- ✓ Të anulohet aktin e emërimit, nr. 156, datë 04.07.2016, sipas parashikimeve të nenit 109 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës;

- ✓ Pozicioni i punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë e Publikun dhe TIK”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Mirditë.
4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mirditë, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me nenin 67 të ligjit për nëpunësin civil, për të rregulluar situatën ligjore duhet të veprojë si më poshtë:
- në kushtet kur, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me statusin e nëpunësve të njësive bashkiake, të cilët fillimi i efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, i ka gjetur në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, duhet të finalizohet procesi i deklarimit të statusit të punësimit, për këta punonjës, të cilët janë të punësuar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil pranë këtij subjekti.
  - të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësen \*\*\*\*\*, e punësuar në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Monitorimit të Investimeve dhe Hartimit të Projekt preventivave në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit Territorit dhe Strehimit”, pozicion i cili është pjesë e shërbimit civil, pasi i plotëson kërkesat e përkufizimit të dhënë në nenin 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohen kriteret për kategorinë e nëpunësit civil.
  - të refuzojë statusin e nëpunësit civil dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Inspektor Finance në Sektorin e Menaxhimit Financiar në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Supervizionit”, pasi ajo nuk e plotëson kriterin arsimor.
5. Njësia përgjegjëse të shpallë si të lira pozicionet e punës, që do të mbeten vakante pas zbatimit të detyrave që ka lënë Komisioneri, për t’u plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore dhe në koherencë me nevojat e institucionit sipas strukturës së Bashkisë Mirditë.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
7. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mirditë, të njoftojë për këtë vendim si dhe për përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, të gjithë subjektet e ngarkuara me detyra specifike prej ligjit për nëpunësin civil, për administrimin e shërbimit civil në rolin e eprorit direkt, Zyrtarit Raportues, Zyrtarit Kundërfirmues dhe Zyrtarit Autorizues, në këtë institucion, të cilët do

të mbajnë përgjegjësi personale për mosrespektimin e kërkesave të ligjit për nëpunësin civil, në rast se nuk veprojnë për të rivendosur ligjshmërinë brenda afatit të vendosur nga Komisioneri për zbatimin e këtij vendimi.

8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Mirditë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të dokumentojë të gjitha veprimet që vërtetojnë masat e marra.
9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe njësia përgjegjëse, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme.
10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**